

## PROTOKOLLI JESHIL I MASAVE-HIGJENO SANITARE COVID-19

Subjekti fillimisht verifikon objektin e veprimtarisë së tij duke vetëpërcaktuar nivelin e riskut sipas kodeve të veprimtarisë. Në rast të aktiviteteve me natyrë të përzier ku një subjekt ushtron disa aktivitete, vetëpërcaktimi do të kryhet sipas adresave sekondare dhe llojit të çdo aktiviteti. Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar.

Personi i caktuar nga administratori/personi fizik kryen çdo ditë vetëvlerësimin personal dhe të personave të punësuar nëse kanë simptoma të COVID-19 sipas *checklist* të miratuar. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127.

Për çdo rast administratori/personi fizik tregtar lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektoriatin Shëndetësor Shteteror.

### Subjekti duhet të:

- Ofrojë në hyrje produktin higjenzues të duarve për klientët dhe të kujdeset për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60%;
- Afishojë në një vend të dukshëm në fasadë mundësinë e blerjeve *online*, mundësinë e rezervimit të takimit *online* apo me telefon;
- Vendosë xham mbrojtës (ose *plexiglass*) klient-shitës dhe shirit distance në banakun e arkës;
- Kryejë dezinfektim të ambientit dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes, sidomos të tavolinave, banaqeve, telefonave dhe çdo hapësire ku ka patur kontakt prekje;
- Sigurojë ajrim sipas mundësisë minimalisht 3 herë në ditë. Ky detyrim për subjektet si parfumeri apo gjatë të cilave prodhohen gazra duhet të kryhet 6 herë në ditë;
- Afishojë detyrimin për vetëvlerësim të simptomave nga klientët dhe personeli i punësuar/administratori/personi fizik tregtar sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore si dhe numrin jeshil për denoncim;
- Afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas *checklist* të miratuar;
- Shërbejë vetëm një klient në ambient, ndërkohë që të tjerët presin jashtë në rradhë me distancë 2 metra nga njëri-tjetri. Në ambientet më hapësirë mbi 30 metra katrorë mund të lejohet proporcionalisht një klient tepër për çdo 10 metra katrorë shtesë ambienti duke orientuar klientët në ruajtjen e distancës.

## **Personeli i punësuar/Administratori/Personi Fizik Tregtar duhet të:**

- Përdorë dorezat mbrojtëse sipas këshillave;
- Mbajë maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën.

## **Rregulla të përgjithshme:**

- Punonjësi i arkës lan duart dhe i dezinfekton ato paraveshjes dhe pas zhveshjes se dorezave;
- Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik shitës-klient;
- Duhet të garantohet dhe respektohet në çdo moment distanca prej 2 metra midis klientit dhe personelit të punësuar;
- Klienti dezinfekton duart në hyrje dhe dalje nga subjekti. Klienti mban dorezat dhe maskën mbrojtëse sipas këshillave.

## GREEN PROTOCOL OF SANITARY-HYGIENE MEASURES COVID-19

The entity initially verifies the object of its activity by self-determining the level of risk according to the activity codes. In case of activities of a mixed nature where an entity exercises several activities, self-determination will be performed according to the secondary addresses and the type of each activity. The entity is allowed to carry out the activity during the permitted time slot.

The person appointed by the administrator/ entrepreneur performs daily its self-assessment and that of its employees if they have symptoms of COVID-19 according to the approved checklist. In case of symptoms, the continuation of the activity should not be allowed in any case and should be reported immediately as a case by calling 127.

In any case, the administrator/entrepreneur shall immediately notify the relevant structures, especially the Local Health Care Unit and the Public Health Inspectorate.

### **The entity should:**

- Provide in-service hand sanitization product to customers and take care of their replenishment. The percentage of the active substance should be at least 60%;
- Display in a noticeable place on the facade the possibility of online shopping, the possibility of booking an online or telephone meeting. It is recommended the delivery service as much as possible;
- Place protective glass (or plexiglass) between seller and customer and distance tape on the cash register counter;
- Perform disinfection of the environment and cleaning before opening and after closing, especially of tables, counters, telephones and any space where there has been touch contact;
- Provide ventilation as much as possible at least 3 times a day. This obligation for entities such as perfumery or during which gases are produced must be performed 6 times a day;
- Display the obligation for self-assessment of symptoms by clients and staff employed / administrator / entrepreneur according to the approved format where administrative or criminal liability is mentioned for the person who does not take measures according to legal obligations as well as the toll free number for denunciation;
- Display the list of COVID-19 symptoms according to the approved checklist;
- Serve only one customer in the premises, while others wait outside in line, 2 meters apart. In premises with a space of more than 30 square meters, it might be allowed another client, proportionally for every 10 square meters of additional space, orienting the customers in maintaining the distance.



**Employed personnel/Administrator/Entrepreneur should:**

- Use protective gloves following the advice;
- Use the protective mask by covering nose and mouth.

**General rules:**

- The cashier washes her/his hands and disinfects them before putting on the gloves and after taking them off;
- In no case is allowed the physical contact between the seller and the customer;
- The distance of 2 meters between the client and the employed staff must be guaranteed and respected at all times;
- The client disinfects hands at the entrance and exit of the entity. The client wears gloves and a protective mask following the advice.